

Nr. Prot.: 94/2025

Datë: 07.07.2025

Bazuar në Ligjin Nr.02/L-42 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në Udhëzimin Administrativ Nr. 22/2013, Rregulloren e Brendshme për Regjistrimin e Nxënësve, Vendimin e Ri-Akreditimit nga Autoriteti Kombëtar të Kualifikimeve Nr. 01/149, të datës 19.03.2025 dhe Vendimit Nr. 01/363, të datës 02.05.2025 si dhe bazuar në Vendimin e Komisionit për Licencim të MASHTI-t Ref.nr: 3/878, të datës 20.05.2024 dhe Vendimit Ref.nr: 3/1000, të datës 30.05.2025 , Shkolla e Mesme e Mjekësisë në kuadër të Kolegjit ISPE shpall:

K O N K U R S

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLËN E MESME TË LARTË PROFESIONALE NË KUADËR TË KOLEGJI ISPE PËR VITIN SHKOLLOR 2025/2026

1. Për pranimin e nxënësve të rinj në Shkollën e Mesme të Lartë Profesionale, për vitin shkollor 2025/2026;
2. Konkursi shpallet për Kualifikimet e Validuara dhe Akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve si dhe të Licencuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit:
 - Infermieri e Përgjithshme;
 - Teknik Dentar;
 - Asistent i Fizioterapisë;
 - Teknik i Farmacisë
 - Teknologji e Informacionit Komunikimit dhe Elektronikë.

3. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve:

- Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç;
- Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e IX- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

4. Dokumentet e nevojshme për konkurrim:

- Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të, duhet të paraqesin këto dokumente:
 - ✓ Fletëparaqitjen (e cila merret në Kolegjin ISPE);
 - ✓ Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9);
 - ✓ Çertifikatën e lindjes dhe
 - ✓ Dy fotografi

5. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve:

- Paraqitja e dokumenteve për vitin shkollor 2025/26, bëhet nga data **07/07/2025** deri më datë **28/08/2025**.
- Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen me datën **29/08/2025**.
- Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës **29/08/2025**.
- Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHTI - komisionit për ankesa.

6. Kriteret për regjistrim:

- Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë kriteret sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013.

Drejtör:

Avni Mazrreku



Prishtinë, 07 Korrik 2025